



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 7556/prot.
11

Tiranë, më 15. 11. 2022

UDHËZIM

Nr. 31, datë 15. 11. 2022

PËR

PROCEDURAT PËR KODIFIKIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të vendimit nr. 310, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e kodit të programeve të studimit, sipas elementëve të mëposhtëm:
 - a) Përcaktimi i nivelit të programit të studimit, sipas nivelit të përcaktuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit.
 - b) Kohëzgjatja e programit të studimit.
 - c) Lloji i programit të studimit.
 - d) Fusha e detajuar në të cilën bën pjesë programi i studimit.
 - e) Gjuha e programit të studimit.
2. Për programet ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë (në vijim IAL), duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre të argumentuara lidhur me kodet që duhet të përmbajnë të gjitha programet që ofrojnë, të grupuara sipas njërive kryesore të IAL-së, shoqëruar me planet e tyre mësimore, si dhe të dhënat për aktin e hapjes dhe/ose akreditimit të programit të studimit (nëse ka).
3. Vlerësimi i propozimeve të IAL-së kryhet nga Komisioni i përkohshëm (në vijim Komisioni), i përbërë nga 3 (tre) ekspertë, sipas fushës, të përzgjedhur nga lista e

ekspertëve të jashtëm të miratuar nga Bordi i Akreditimit. Këto Komisione ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Komisioni, vlerëson propozimet e IAL-ve, sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011) dhe Fushat e Arsimit dhe Trajnimit të KSNA-së (KSNA-F 2013) dhe legjislacionit në fuqi për kodifikimin, brenda 45 ditëve nga përcjellja e dokumentacionit nga ministria përgjegjëse për arsimin.
5. Komisioni, pas vlerësimit, harton raportin me vlerësimin përkatës dhe e depoziton në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në raportin e vlerësimit Komisioni i propozon ministrit konfirmimin e kodit për programin e studimit ose jep rekomandim lidhur me atë program studimi.
6. Në rast se Komisioni gjatë vlerësimit konstaton që propozimi i IAL-së nuk është i plotë, ministria përgjegjëse për arsimin njofton zyrtarisht IAL-në mbi mangësitë e konstatuara. IAL dërgon plotësimet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.
7. Në rast se Komisioni gjatë vlerësimit konstaton që propozimi i IAL-së është në përputhje me përcaktimet ligjore mbi kodifikimin e programit të studimit, ministri përgjegjës për arsimin konfirmon kodin për programin përkatës, duke njoftuar IAL-në dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore me shkresë zyrtare.
8. IAL-të, në aplikimin për hapjen e programeve të reja dhe/ose të riorganizuara të studimit në masën mbi 20 %, duhet të përfshijnë dhe propozimin për kodin e programit.
9. Ministria përgjegjëse për arsimin vlerëson propozimin e IAL-së, në funksion të procedurave për hapjen dhe/ose riorganizimin e programit të studimit, të përcaktuara në udhëzimin përkatës.
10. Kodi i programit të studimit përfshihet në aktin e hapjes dhe/ose riorganizimit të programit të studimit.
11. Kodi, për secilin program studimi, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
12. Për programet ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre brenda muajit mars 2023.
13. Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankim nga IAL, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila ia përcjell për rishikim komisionit përkatës. Komisioni, brenda 15 ditëve, pas rishqyrtimit të ankimit, merr vendimin përfundimtar.

14. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

EVIS KUSHI

